

Si E Shëron Perëndia Zembrën?

Sa prej jush kanë patur një ose më shumë se një kockë të thyer, gishti, dore apo këmbë?

Sa prej jush kanë patur kapëse?

Sa prej jush kanë bërë operacion të çdo lloji?

Sa kanë prerë me thikë gishtin ose dorën qoftë edhe në kuzhinë?

Sa prej jush kanë patur ndonjë plagosje me armë?

Sot do të shohim Si E Shëron Perëndia Zembrën?

Mund të jenë kujtime që të lëndojnë, janë grumbulluar nga e kaluara dhe sa herë i kujton të dhemb zemra.

Kujtesë braktisjeje. Disa nga ju kanë kujtime të tilla si:

Kritika të vazhdueshme, keqdashje, të kanë urryer ose mohuar ose ke përjetuar abuzim emocional, shpirtëror e fizik.

Nga merren këto plagë?

Nga kudo! Mund t'i marrësh nga anëtarët e familjes, nga shoqëria, nga prindërit, vëllai, motra, xhaxhallarët, dajat, tezet, fisi, në oborrin e shkollës, në punë, në pushimin e drekës. Kudo.

Këto janë plagët që të dhembin më shumë!

Ja disa të vërteta:

Së pari, çdo njeri ka të paktën një plagë të fshehur. Një të çarë emocionale nga dikush që e ka lënduar pak, shumë ose shumë fare.

Së dyti, plagët e brendshme duan më shumë kohë për t’u shëruar sesa ato që janë fizike. Ushtarët që vijnë nga lufta të plagosur, mund të shërohen nga ana fizike por nuk i harrojnë dot skenat e luftës, kalojnë depresion.

Së treti, pas COVID-it, njerëzit kanë më shumë marrëdhënie të prishura. Statistikat tregojnë 3 deri në 7 grindje dhe mosmarrëveshje në vit të cilat shoqërohen me lëndime.

Lajmi i mirë është ky: Jezus Krishti dëshiron që të shërojë çdo zemër të lënduar, çdo plagë të brendshme. Ai thotë tek Eksodi.15:26 “Unë jam Zoti që të shëron” dhe Psalmi 147:3 “Ai shëron ata që e kanë zemrën të thyer dhe lidh plagët e tyre”.

Si e bën Perendia një gjë të tillë? Në Bibël lexojmë për Jezusin që Ai shëroi shumë njerëz—nga ana fizike dhe emocionale. Ka disa modele dhe parime sesi Ai merrej me njerëzit. Këto 5 parime janë procesi shërues i Perëndisë për një zemër të lënduar.

PARIMI 1

Nxirre Lëndimin

Nëse nuk merresh siç duhet me lëndimin, nuk shërohesh. Bibla flet kur e mban përbrenda problemin dhe nuk flet me njeri për të.

Psalmi 39:2-3 “*Kam qëndruar i heshtur dhe i qetë... dhe dhembja ime është ashpërsuar. Zemra më digjte përbrenda ndërsa mendohesha, një zjarr u ndez.*”

Perëndia thotë se ta mbash brenda lëndimin është sikur të mbash thëngjij në zemër—ke për të djegur veten. Kur e lë mënjanë nuk është shërim, thjesht gjërat përkeqësohen.

Një nga arsytet e hutimit të vazhdueshëm vjen për shkak se je duke e përdorur energjinë emocinale për t’u hidhëruar, për të mbajtur inate, për të fajësuar veten, për të ndjerë keqardhje për gjërat e shkuara; kjo është arsyeja se pse ndihesh i lodhur gjithë kohës, edhe kur nuk ke bërë asnjë punë.

Psalmi 32:3 “*Ndërsa po heshtja, kockat e mia treteshin midis rëndimeve që kisha tërë ditën.*”

Davidi po thahej emocionalisht. Për shkak se ne jetojmë në një botë plot mëkat, njerëzit lëndojnë njëri-tjetrin. Nuk ka dyshim që disa prej jush sot jeni lënduar në një mënyrë apo një tjetër nga dikush.

Njerëz të ndryshëm reagojnë ndryshe:

Disa përpiqen të harrojnë. “*Do e heq nga mendja, do e harroj*”. Por nuk e harron dot, vetëm sa rritet.

Disa “largohen” prej lëndimit. Ka shumë mënyra ikjeje për të shpëtuar—fillojnë cigaren, pijet alkoolike, disa punojnë shumë që ta heqin mendjen, disa bëjnë seks me të tjerë.

“Ai më la mua, për inat të tij do shkoj me një person tjetër”. Për inat të vjerrës do shkoj me mullixhiun.

Disa përpiqen ta injorjnë, sikur nuk ekziston, nuk më ka ndodhur gjë.

Disa përpiqen të fajësojnë të tjerët.

Disa mundohen ta mbulojnë, por një ditë do të shpërthejë.

Asnjë nga këto mënyra nuk funksionon.

Ajo që duhet të bësh është të jesh i singertë në lidhje me dhimbjen, zemërimin, me lëndimin që të është shkaktuar nga ajo që të kanë bërë.

Po me kë të jesh i singertë? Me tre persona:

Së pari, ji i singertë me veten. Të vish në pikën që ta pranosh: “*Kjo gjë po më lëndon!*”

Së dyti, ji i singertë me Perëndinë. Thuaji: “*Perëndi, ja si ndihem!*” Hapja zemrën Atij. Perëndia mund ta përballojë situatën tënde. Ai e di sesi ndihesh gjithsesi. Nuk ka për t’u habitur sepse Ai e ka parë, madje Ai lëndohet bashkë me ty. Ai të do, Ai do që të jesh i singertë me Të. Është për të mirën tënde. Nxirre nga vetja jote.

Së treti, ji i singertë të paktën me një person të cilit i beson. Fol me dikë dhe tregoja fije për pe sesi ndihesh. Ka diçka shëruese kur ia hap zemrën dikujt tjetër.

Jobi 18:4 “*Ti që ha veten (që e gërryen veten) nga zemërimi...*”. Pra nxirre nga vetja. S’ka shërim pa e nxjerrë atë që të lëndon.

PARIMI 2

Fali Ata Që Të Kanë Lënduar

Për të mirën tënde hiq dorë nga hakmarrja. Fakt është që ti ke “*x-iks*” sasi energjie emocionale. Me këtë energji që ke, a *do shërohesh apo do hakmerresh?* Nuk i bën dot të dyja.

Sekret: Hakmarrja nuk ta heq dhimbjen. Disa nga ju mund ta keni provuar vetë. Ti mund t’ia kesh kthyer atij personi në një farë mase atë që të bëri, por e pe që nuk të zgjidhi punë sepse akoma e ndjen dhimbjen. Ka vetëm një mënyrë për ta hequr dhimbjen nga zemra, vetëm një rrugë.

Falja. E di që po mendon: “*Ai/ajo nuk e meriton!*” Nuk po them që e meriton. Ke të drejtë, nuk e meriton. Por as ti nuk e meritove, por Perëndia prapë të ka falur. Edhe nëse akoma s’e ke këtë falje, Ai është gati për ta bërë një gjë të tillë. Fale për të mirën tënde. Nuk mund të ecësh përpara nëse në mendje ke ngecur tek e kaluara. Për sa kohë je i kapur pas hakmarrjes, ke ngecur. Ai person akoma po e kontrollon jetën tënde sot edhe pse ai person mund të jetë larguar nga ty prej shumë vitesh.

Romakëve 12:17-19 “*Mos ia ktheni kurrkujt të keqen me të keqe. Mos u hakmerrni për veten. Por i jepni vend zemërimin të Perëndisë sepse është shkruar, ‘Mua më përket hakmarrja, unë kam për ta shpague, ’ thotë Zoti.*”

Arsyeja përse e fusim veten në telashe është se e harrojmë këtë gjë. Harrojmë që Perëndia e ka parë të gjithë lëndimin që na është bërë. Nuk është detyra jote për ta barazuar situatën. Perëndia thotë kjo është puna Ime, hakmarrjen e kam Unë. Lërja Zotit ta barazojë situatën për ty. Ai ka për të vënë drejtësinë në vend.

Psalmi 56:8 “*Ti, O Perëndi, i ke numëruar lotët e mia.*”

Asgjë nuk i shpëton shikimit të Perëndisë.

Jezusi sigurisht që e kupton keqtrajtimin, Atë e keqtrajtua. Të sugjeroj të veprosh ashtu si Jezusi. *Kur Jezusin e fyenin, nuk e kthente fyerjen; kur vuante, nuk kërcënonte; por dorëzohej tek Ai që gjykon drejtësisht.*

Jezusi pati 6 plagë përpara se të vdiste. Plagë në kokë nga kurora me gjemba, plagë në fytyrë, shpinën e plagosur nga kamzhikët, duart dhe këmbët e shpuara me gozhdë, në ijë ishte i çarë me shtizë.

Por plaga më e thellë ishte në zemrën e Tij sepse Jezusin e tradhëtoi një nga 12 shokët e Tij, i cili e shiti për disa monedha. Një tjetër shok i Tij e mohoi, shumë e urryen, u keqtrajtua. Jezusi mund t’i shkatërronte të gjithë në një

sekondë por në vend të kësaj, Ai i shtriu duart në kryq dhe tha: “*Atë, fali sepse nuk dinë ç’bëjnë.*”

Përse t’i fal ata që më kanë lënduar?

Një, sepse në këtë mënyrë mund të falë Perëndia dhe ty
Dy, sepse do të kesh nevojë për falje në të ardhmen.

Tre, sepse është e vetmja mënyrë shërimi, nuk ka rrugë tjetër. **Hebrenjve 12:15** *Mos mbijë ndonjë rrënjë e hidhur dhe t’ju turbullojë dhe me anë të saj të ndoten shumë njerëz.*

Një person i hidhur nuk lëndon vetëm veten, por edhe të tjerët përreth. Kur je i hidhëruar, lëndon herë pas here njerëz të pafajshëm, pjestarë të familjes, shokët.

Mënyra e shërimit është kur *E Nxjerr Lëndimin*, pra *Kur Flet dhe Kur i Fal* ata që të lëndojnë.

PARIMI 3

Zëvendësoji Kujtimet, “Videot” e Vjetra Me Të Vërtetat e Perëndisë.

Truri është si kompjuter, si telefoni kur bën video.

Truri yt ka regjistruar çdo përvojë që ke përjetuar me 5 shqisat e tua—gjërat që ke nuhatur, që ke parë, dëgjuar, prekur dhe shijuar—e gjitha është këtu.

Në trurin tonë janë të regjistruara—e mira, e keqja, e drejta, e gabuara, e vërteta, mashtrimi, e bukura dhe e shëmtuara.

Por ka një problem: Truri, sidomos kur je i vogël, nuk e dallon qartë se çfarë është e vërtetë dhe çfarë jo. Kur ke qenë i vogël të janë thënë gjëra që s'ishin të vërteta, por ti i ke besuar. Dhe kur i ke besuar ke vepruar sipas tyre.

Ndoshta disave kur kanë qenë të vegjël ju është thënë:
“Je i ngathët, sa i mangët që je... Sa i shëmtuar... Më vjen turp që je fëmija im... Ti s'merr vesh fare... Sa i trashë që je... Pse s'i ngjave një çikë motrës/vëllait... Ti s'ke për të çarë në jetë asnjëherë...”
 e me radhë.

Këto gjëra u regjistruan në trurin tënd dhe pas 10-15-20 vjetësh a më shumë dhe ende mund të jesh duke u sjellur sipas këtyre “regjistrimeve” të vjetra. Ndoshta ti habitesh dhe thua: “përse s'po eci përpara?” Ajo që duhet të bësh është t'i zëvendësosh këto kujtesa të vjetra me të vërtetat e Perëndisë.

Romakëve 12:2 *“Por transformohuni me anë të ripërtëritjes së mendjes suaj.”* (ndrysho mënyrën si i mendon gjërat).

Si mund ta ndryshojë Perëndia një njeri? Si mund ta transformojë? Duke ndryshuar mënyrën si mendon.

E si bëhet kjo gjë?

Së pari, bisedo me Perëndinë duke i thënë: *“Perëndi të lutem ma shëro kujtesën. Këto gjëra më lëndojnë. Filloje këtë proces shërimi tek unë.”*

Së dyti, mbushe mendjen me Fjalën e Perëndisë, Biblën. Sa më shumë e lexon dhe e mbush mendjen me Biblën, aq më shumë gënjeshtër kanë për të ikur. Lexoje Biblën çdo ditë.

Së treti, beso të vërtetat që thuhet për ty.

Cila është e vërteta?

Efesianëve 1:4-5 *“Perëndia na zgjodhi me anë të asaj që Krishti bëri për ne, që të jemi të shenjtë dhe të patëmetë (pa faj) përpara Tij në dashuri.”*

Të tillë e shikon Perëndia një person që hedh hapin e besimit dhe pranon Jezusin në jetën e tij. Pa asnjë faj.

Ai i merr të gjitha që ke bërë në të shkuarën: fajin, keqardhjet, turpin, lëndimin, mëkatin—i fshin të gjitha, i fal te gjitha dhe thotë: *“Eja t’ia fillojmë nga e para, sikur nuk ka ndodhur asnjë gjë.”* Pas kësaj Perëndia të shikon pa asnjë faj.

E arrite vetë një gjë të tillë? Jo! Por, për shkak të dashurisë që pati Jezus Krishti për ty, aq e madhe saqë vdiq në kryq për ty. Ky është lajmi i mirë.

Psikologët kanë provuar se shpesh, mënyra si e shikon njeriu veten, vlerësimi që i bën vetes, si e koncepton veten —përcaktohet shumë nga mënyra si e percepton opinionin e personit më të rëndësishëm të jetës tënde për ty.

Mënyra si e shikon veten bazohet në mënyrën si mendon personi më i rëndësishëm i jetës tënde.

Ajo që dua të sugjeroj sot është: Bëje Jezus Krishtin personin më të rëndësishëm të jetës tënde. Sepse vetëm Ai thotë të vërtetën e plotë për jetën tënde. Të tjerët kanë për të gënjer.

Pra, është vendimi yt. A do të dëgjosh gënjeshtarët (ti s'ke vlerë, ti je hiç). Apo do të dëgjosh atë që do të thotë Jezus Krishti për ty?

Bibla thotë se kur i takon Krishtit ti ke vlerë, ti je i pranuar gjithmonë, Ai të do gjithë kohën, je i falur, je i fituar, je njësh para Perëndisë. Këto thotë Ai!

Pyetja ngelet: Kë do të besoj? Ato që kanë thënë të tjerët për mua? Apo do besoj ato që thotë Perëndia? Zgjedhja mbetet e jotja.

PARIMI 4

Fokusohu Tek e Ardhmja

Hiqe mendjen nga e shkuara dhe shiko planin e Perëndisë për të ardhmen tënde. Ka 3 hapa sesi të fokusohesh tek e ardhmja. Ato gjenden tek:

Jobi 11:13-16 (interpretim) *“Në rast se e përgatit zemrën tënde, shtriji duart drejt Perëndisë dhe përballu me botën përsëri, do të jesh i patundur dhe nuk do të kesh frikë. Dhe të gjitha hallet e tua do të ikin si uji që rrjedh dhe s’do të mbahen mend më.”*

Së pari, thuhet: *“Përgatite zemrën.”* Do të thotë, hiq dorë nga hakmarrja, fali ata që të kanë lënduar, e meritojnë apo jo. Bëj gjënë e duhur, e cila është falja.

Së dyti, *“Shtriji duart drejt Perëndisë.”* Ke nevojë t’i kërkosh Jezus Krishtit të vijë dhe të hyjë në jetën tënde dhe duhet t’i kërkosh Atij të fillojë ta shërojë zemrën dhe të fillojë të nxjerrë të mirën nga e keqja. Nëse do që të shërohesh hiqe mendjen nga lëndimi yt dhe fokusohu tek Shëruesi yt. Ai është *Perëndia që të shëron*. Ai është përgjigja. Askush tjetër.

Së treti, *“përballu me botën përsëri.”* Mos u veço. Mos rri në vetmi. Jetoje jetën. Mos thuaj: *“Unë jam i humbur, jam fajtor, jam viktimë.”* Ti nuk je, çohu, shiko para, ec përpara!

Nëse i ndjek këto hapa, shiko se çfarë mund të ndodhë: *“Dhe të gjitha hallet e tua do të ikin si uji që rrjedh dhe s’do të mbahen mend më.”*

A të pëlqen kjo? A nuk do të doje që të gjitha shqetësimet e tua të iknin nga kujtesa jote? *Atëherë, ndiqi këto hapa.*

-Nxirre Lëndimin tënd.

-Fali ata që kanë lënduar,

-Zëvendëso kujtimet e vjetra me të vërtetat e Perëndisë,

-Fokusohu te e ardhmja.

Atëherë mund të thuash si te: **Fjalët e Urta 4:25** “*Sytë e tu le të shohin drejt përpara, dhe qëpallat e tua të synojnë drejt para teje.*”

Njerëzit provojnë lloj-lloj mënyrash për t’u qetësuar në jetë, unë të them që është vetëm Jezus Krishti. Bota mund të ofrojë qetësues të përkohshëm, por nuk e zgjidhin problemin. Jepja jetën Krishtit që thotë: “*Unë jam Perëndia që të shëron.*” Dhe kur je shëruar tregoj të tjerëve mënyrën sesi u shërove.

Vijmë tek i fundit...

PARIMI 5

Nëse nuk po ndihmon askënd, nuk je shëruar akoma. Ky është parimi i pestë i procesit të shërimit të Perëndisë. Duhet t’i përdorësh përjetimet e tua për të ndihmuar persona të tjerë që po kalojnë të njëjtën situatë si ty. Perëndia do që të ndihmojmë njëri-tjetrin, Ai mund ta përdori për mirë lëndimin tënd.

2 Korintasve 1:4 “*Perëndia na ngushëllon ne në çdo shtërngim tonin, dhe pasi ai na ka ngushëlluar të mund të ngushëllojmë ata që janë në çfarëdo shtërngimi.*”

A ke nevojë për t’ia filluar nga e para? Nëse po, oferta është gati. “*Kur dikush është në Krishtin ai është një krijesë e re, gjërat e vjetra shkuan dhe u bënë të gjitha të reja.*”

Disa nga ju e kanë hedhur hapin e parë. Ti e ke pranuar Krishtin në zemrën tënde. Por nuk e ke nxjerrë lëndimin, nuk i ke faluar ata që të kanë lënduar, s'i ke zëvendësuar regjistrimet e vjetra me të vërtetat e Biblës. Por mund ta fillosh sot, sepse sot është një mundësi e re.

Lutje:

Ti je Perëndia që të shëron, unë besoj tek Ti!

Lutja e Shpëtimit